



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Data 11.04.2025
Nr. 2775/2 Prot.

FTESË PËR NEGOCIATË

PËR

**AGJENCITË E SPECIALIZUARA/ORGANET E MEDIAVE VIZIVE PËR
“TRANSMETIMIN E MESAZHIT PROMOCIONAL MBI MËNYRËN E PLOTËSIMIT
KORREKT TË FLETËS SË VOTIMIT, NË EMISIONET TELEVIZIVË NË FASHAT
ORARE MË TË NDJEKURA” PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË
DATËS 11 MAJ 2025.”**

Bazuar në pikën 6 të vendimit nr.1195, datë 05.08.2008, “Për blerjen, zhvillimin prodhimin e bashkëprodhimin e programeve apo të reklamave për transmetim nga operatorët audiovizivë ose botimin në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”, të Këshillit të Ministrave, vendimit nr. 214 datë 20.12.2024, “Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore, për programin “Zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore” të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Vendimin nr.206, 207 dhe 208 të datës 11.12.2024, “Për miratimin e Programit për Edukimin, Informimin dhe Ndërgjegjësimin e zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2025”, marrëveshjes me nr. 1893 prot, datë 24.03.2023, “Mbështetje e Parlamentit dhe edukimit qytetar. Mbështetje për KQZ-në” të lidhur me qeverinë Zviceriane si dhe urdhrin të delegimit të detyrave me nr. 6 datë 09.01.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në cilësinë e nëpunësit të autorizuar.

OBJEKTI

“Transmetimin e mesazhit promociional mbi mënyrën e plotësimit korrekt të fletës së votimit, në emisionet televizivë me audiencë më të lartë në fashat me orare më të ndjekura, në kuadër të një aspekti të rëndësishëm të zgjedhësve për informimin e plotësimit korrekt të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në kuadër të fushatës edukuese të zgjedhësve brenda dhe jashtë vendit do të trasmetojë mesazhin promociional mbi mënyrën e plotësimit korrekt të fletës së votimit, në emisionet televizivë me audiencë më të lartë në fashat me orare më të ndjekura, në



kuadër të një aspekti të rëndësishëm të zgjedhësve për informimin e plotësimit korrekt të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në kuadër të fushatës edukuese të zgjedhësve brenda dhe jashtë vendit, do të trasmetojë në emisione më audiencë më të lartë, mesazh promociional mbi mënyrë e plotësimit korrekt të fletës së votimit. Nisur nga rëndësia dhe përmbajtja e fletës së votimit, si dhe nga kërkesat e shumta nga qytetarët mbi mënyrën e plotësimit korrekt të fletës së votimit, komisioni vendosi të zhvillojë procedurën për transmetimin e mesazhit promociional në emisionet me audiencë më të lartë në televizionet kombëtare dhe rajonale. Ky mesazh do të jepet nga vetë prezantuesit e emisioneve duke demonstruar hapat e plotësimit korrekt të fletës së votimit me demon e fletës së votimit të ofruar nga vetë KQZ-ja.

1. Trasmëtimi nga operatorët televizivë

Trasmëtimin e mesazhit promociional mbi mënyrën e plotësimit korrekt të fletës së votimit, në emisionet televizivë me audiencë më të lartë në fashat me orare më të ndjekura, në kuadër të një aspekti të rëndësishëm të zgjedhësve për informimin e plotësimit korrekt të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025.

2. Ftesa për negociata për “Trasmëtimin e mesazhit promociional mbi mënyrën e plotësimit korrekt të fletës së votimit, në emisionet televizivë me audiencë më të lartë në fashat me orare më të ndjekura, në kuadër të një aspekti të rëndësishëm të zgjedhësve për informimin e plotësimit korrekt të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”.

A- Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Adresa: Rruga Ibrahim Rugova, nr.4

Tel/Fax: +355 4 4510810

E-mail: ermina.allushi@kqz.gov.al

Adresa e Internetit: www.kqz.gov.al

B-Periudha e realizimit të shërbimit: 2 (dy) javë nga data e nënshkrimit të kontratës.

C-Fondi limit i përcaktuar: fondi limit i procedurës është në vlerën është 7,400,000 (shtatë milion e katërqind mijë) lekë pa TVSH.

D-Data e zhvillimit dhe pranimit përfundimtar të ofertave dhe dokumentacionit do të jetë 17.04.2025 ora 16:00.

Shënim: Dokumentacioni/ofertat duhet të vijnë të gjitha të mbyllura në zarf jo transparent, të firmosura dhe vulosura në emrin dhe adresën e subjektit dhe me shënimin: Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni.

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj dhe dokumentacionin përkatës për këtë objekt me këto të dhëna (specifikimet teknike të mallit/shërbimit/punës):

E- Shërbimet që kërkohen të realizohen:

Përshkrimi i shërbimit është: Transmetimin në emisione prime-time të mesazhit promocional mbi mënyrë e plotësimit korrekt të fletës së votimit. Ky mesazh do të jepet në harkun kohorë 2 (dy) javë para datës së zgjedhjeve nga vetë prezantuesit e emisioneve duke demonstruar hapat e plotësimit korrekt të fletës së votimit me demon e fletës së votimit të ofruar nga vetë KQZ-ja. Transmetimi i mesazhit promocional do të kryhet nga prezantuesi çdo ditë që emisioni transmetohet në harkun kohorë dy javorë, në ditët që transmetohet emisioni, sipas mediaplanit të kërkuar nga KQZ-ja.

Mesazhi që do të transmetohet është si vijon:

*Në zgjedhjet e datës 11 maj, votohet vetëm me NJË fletë votimi.
Ju mund të votoni në një nga mënyrat e treguara në vijim, përndryshe fleta e votimit do të jetë e pavlefshme.*

- a) Nëse doni të votoni vetëm për partinë, apo vetëm për koalicionin, vendosni shenjën (X) ose (+) brenda kutisë përbri emrit të partisë apo koalicionit të partive që doni të votoni.*
 - b) Nëse doni të votoni VETËM për NJË nga kandidatët që është në listën parapëlqyese vendosni shenjën (X) ose (+) brenda kutisë përbri emrit të kandidatit që keni zgjedhur.*
- Në këtë rast, vota juaj llogaritet për kandidatin që keni zgjedhur, njëkohësisht edhe për partinë apo koalicionin të cilit i përket ky kandidat.*

KUJDES! Ju nuk mund të votoni për një parti apo koalicion dhe njëkohësisht për kandidatin e një partie apo koalicioni tjetër

Voto të dëgjohesh!

F- Për realizimin e këtij shërbimi Autoriteti Kontraktor kërkon nga operatorët ekonomik dokumentacionin përkatës si më poshtë:

- a) Ekstrakti historik i regjistrit tregtar.
- b) Vërtetim për statusin aktiv.
- c) Deklaratë mbi konfliktin e interesit.
- d) Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur.

- e) Mediaplanin e transmetimit të mesazhit në emision mbi të cilat ka ofertuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre të lëshuara jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e publikimit të njoftimit për negociatë. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shënim: Përzgjedhja e ofertave do të bëhet sipas pikës nr. 7 dhe 12, të VKM nr.1195 datë 05.08.2008.

G- Kriteret e vlerësimit sipas pikëve:

- Kriteret e përgjithshme: 40 pikë
- Oferta financiare e shoqëruar me mediaplanin për realizmin e kontratës 60 pikë

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në monedhën Lekë.

Kjo ftesë për negociatë do të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në adresën: www.kqz.gov.al si dhe do ju dërgohet edhe me postë zyrtare operatorëve.

Jemi në pritje të konfirmimit tuaj për negocim.

Sekretar i Përgjithshëm

Majlinda ÇELMETA

(Në mungesë dhe me urdhër)